



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 29 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti.

Munguan: Enis Kervan, Shaip Muja dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Mehmeti - KDI, Dren Doli - GLPS, Shefki Kastrati, Besarta Zuka - NDI, dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Njoftim lidhur me punën e deritanishme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm;
3. Diskutim lidhur me organizimin e një tryeze për politikën e jashtme të Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Njoftim lidhur me punën e deritanishme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Albin Kurti i njoftoi se Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është takuar më 18 maj 2012 dhe ka diskutuar për veprimet të cilat do t'i ndërmarrë gjatë kësaj procedure.

Lidhur me zbatimin e ligjit, ai i informoi anëtarët e Komisionit, se Grupi punues ka bërë një vizitë në MPJ-së, të mërkurën, më 27 qershor, ku është zhvilluar një takim pune me zëvendësrektorin e përgjithshëm, sekretarin e përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të MPJ- së.

Sipas kërkesës së Grupit punues, për angazhimin e një instituti ose eksperti, për ta mbështetur punën e Grupit punues, Komisioni në mbledhjen e kaluar, e angazhoi Institutin për Studime Juridike dhe Politike të cilin e përfaqëson Dren Doli.

Mbështetur në Planin e punës së Grupit, propozoi që përshkrimi i detyrave për ekspertin të jetë përputhshmëria e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Ai tha se Komisioni duhet të përcaktohet edhe për kohëzgjatjen e angazhimit të ekspertit dhe për afatin e dorëzimit të ekspertizës.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Eksperti Dren Doli - përfaqësues i institutit Grupi për Studime Juridike dhe Politike, angazhohet për 10 ditë pune, për përgatitjen e raportit lidhur me përputhshmërinë e akteve nënligjore me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të njëjtin do ta dorëzojë më 11 korrik 2012.

3. Diskutim lidhur me organizimin e një tryeze për politikën e jashtme të Kosovës;

Albin Kurti - Theksoi se çështja e organizimit të ndonjë tryeze nga Komisioni, nuk është e radhitur si pikë e veçantë në programin e punës së Komisionit, por gjatë diskutimeve ka pasur propozime që Komisioni të organizojë tryezë debati. Në mbledhjen e kaluar Komisioni ka paraparë që të diskutohet lidhur me organizimin e një tryeze lidhur me politikën e jashtme të Kosovës. Për këtë çështje, tani ne mund të diskutojmë dhe të japim mendimet dhe propozimet tona.

Hydajet Hyseni - Vuri në pah faktin, se shumë çështje që kanë të bëjnë me politikën e jashtme, po e anashkalojnë Komisionin për Punë të Jashtme. Lidhur me organizimin e tryezës, propozoi që të organizohet në partneritet me NDI, eventualisht edhe me ndonjë subjekt tjetër të interesuar. Propozoi disa tema për të cilat tha se do të mund të ishin temë e debatit të tryezës. Sa i përket temës së debatit tha se fillimisht do të mund të fillohej me një temë të përgjithshme, brenda së cilës do të mund të planifikohen një sërë aktivitete. Shprehu mendimin se kush do të mund të ishte i ftuar në këtë tryezë, sa do të zgjaste, ndërsa organizimi i saj tha se do të mund të bëhet në fund të muajit gusht ose në fillim të muajit shtator.

Skender Hyseni - Lidhur me organizimin e tryezës propozoi që, para se të diskutojë për kohëzgjatjen e tryezës, se kush duhet të ftohet në atë tryezë, Komisioni duhet të diskutojë për agjendën e cila do të jetë objekt trajtimi në tryezë.

Sabri Hamiti – E përkrahu organizimin e tryezës, për të cilën tha se duhet të jetë e organizuar nga Komisioni, të zgjasë një ditë, ku temë e diskutimit do të mund të ishte “Politika e jashtme - sukseset, problemet e pritjet”. Kjo temë tha se e krijon mundësinë që të punohet në tri panele. Tryeza propozoi të mbahet në muajin shtator, por duhet pasur parasysh se në të njëjtin muaj do të organizohet edhe një tryezë nga MPJ-ja.

Skender Hyseni - Tha se e mbështet organizimin e tryezës, por angazhohet për specifikim të temës, sepse varësisht nga tema e tryezës ndikohemi që t'i ftojmë pjesëmarrësit. Propozoi që deputeti Hydajet Hyseni, në njërën nga mbledhjet e radhës, të paraqet një draft-propozim konkret për organizim të tryezës.

Amir Ahmeti - Theksoi se e përkrah iniciativën për organizimin e tryezës nga Komisioni. Vlerësoi se do të ishte mirë që Komisioni fillimisht të organizojë një tryezë të brendshme, e pas tre - katër muajsh të shikojë mundësinë e organizimit të një konference, ku do të mund të ftoheshim edhe komisionet homologe, e sidomos ato të vendeve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Propozoi që deputeti Hydajet Hyseni në bashkëpunim me NDI të përgatisin një draft- propozim lidhur me organizimin e tryezës.

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni e nxori këtë

P e r f u n d i m

Autorizohet deputeti Hydajet Hyseni, që të hartojë një draft - propozim për organizimin e tryezës, duke pasur parasysh diskutimet e anëtarëve të Komisionit dhe organizimin e konferencës nga MPJ-ja, në muajin shtator.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti